



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
DEPARTAMENTI I SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVSTVA-MINISTRY OF HEALTH	
Ministria Org.	No. Prot:
Org. J. e. sh. sh.	Org. Prot:
Org. unit:	Post. No. 05-2324
Nr. i faqëve	Data:
Str. sh. sh.	Datum: 14/04/2023
No. pages	-7-
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosova  
Qeveria –Vlada-Government  
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstva Zdravstva-Ministry of Health  
Departamenti Shëndetësor i Burgjeve

REFERENCË:	msh/dshb/mgj/ 75/04/2023				
PËR/ZA/TO:	Dr. Arben VITIA, Ministër i Shëndetësisë;				
PËRMES/PREKO/THROUGH:					
CC:	Znj. Albulena HAXHIU Ministre e Drejtësisë; Dr. Merita BROVINA, Shefe e Kabinetit të Ministrit të MSh; Dr. Naim BARDIQLI, Sekretar i Përgjithshëm i MSh; Z. Sami GASHI, Zv. Drejtor i ShKK/MD				
NGA/OD/FROM:	Prof. Asoc. Dr. Milazim H. GJOCAJ, MD, MSc, PhD; Drejtor i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve, MSh;				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport përmbledhës i aktiviteteve të DShB për tremujorin e parë të vitit 2023				
Nr. i zyrës:	107	Lokacioni:	MSh	Data:	13.04.2023
Br. kancelarije:		Kucni:		Datum:	
Room No.:		Extension:		Date:	
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION					<input checked="" type="checkbox"/>

I nderuar zoti Ministër, Vitia,

Departamenti shëndetësor i burgjeve, bazuar në planin e punës për vitin 2023, buxhetin e aprovuar, stafin që posedon, përpjekjet për zbatimin e Praktikave Standarde të Veprimit, Rekomandimeve Komitetit për Parandalimin e Torturës së Këshillit të Evropës, Raporteve të Inspektorateve dhe Auditorit të brendshëm, ka kryer aktivitet e parapara sipas tabelave të më poshtme:

Të dhënat mbi disa indikatorë të DShB, Janra -Mars 2023		Muajt			Totali,	Totali,
Nr	Indikator	Janar	Shkurt	Mars	tremujori i parë 2023	tremujori i parë 2022
1	Te burgosur te pranuar	553	389	475	1417	1322
2	Te burgosur te liruar	406	358	423	1187	1119
3	Vizita e pare mjekesore ne pranim	553	389	475	1417	1317
4	Konsulta mjekesore	2794	2271	2505	7570	8104
5	Konsulta psikiatrike	596	591	516	1703	1835
6	Konsulta psikologjike	829	558	751	2138	1953
7	Sherbime dentare	312	252	275	839	840
8	Sherbime te tjera mjekesore	2392	1898	2083	6373	4607
9	Totali i konsultimeve shendetesore	6317	5041	5135	16493	16440
10	Hospitalizime ne Stacionarin e burgut	16	7	9	32	32
11	Hospitalizime ne Spitalet Civile	18	16	22	56	54
12	Dergimet jashtë IK per konsultime	260	145	210	615	703
13	Dergimet jashte IK per intervenime	31	13	28	72	96
14	Transferet shendetesore	1	0	2	3	9
15	Rastet me TBC	0	0	0	0	1
16	Rastet me HEPATIT B	0	0	2	2	3
17	Rastet me HEPATIT C	0	0	1	1	2
18	Rastet HIV pozitiv	0	0	1	1	0
19	Aplikimi i Testeve Psikologjike	251	146	218	615	604
20	Analizat e gjakut sipas planit	104	94	78	276	263
21	Analizat e gjakut sipas indikacioneve	58	36	63	157	151
22	Analizat e gjakut per substancave psikotrope	0	0	0	0	6
23	Vizitat sistematike muojre (parametrave vital)	1496	1427	1428	4351	3433
24	Kontrolltet stomatologjike sistematike	43	26	35	104	20
25	Kontrolltet gjinekologjike sistematike	7	5	2	14	0
26	Mamografi	0	0	0	0	0
27	PAPA test	0	0	0	0	0
28	RTG Pulmo	18	17	15	50	31
29	Neurotic Syndromes	250	201	249	700	798
30	Psychotic Syndromes	37	28	34	99	130
31	Semundjet kardiovaskulare	78	60	88	226	235
32	Semundjet Respiratore	199	179	121	499	569
33	Semundjet gastrointestinale	135	97	144	376	360
34	Semundjet urogenitale	55	88	52	195	154
35	Semundjet e lekures	70	55	80	205	210
36	SS te transmetueshme	0	1	0	1	3
37	Semundjet e sistemit lokomotor	103	69	113	285	365
38	Semundjet infektive	2	1	3	6	18
39	Vete lendimet	17	9	9	35	29
40	Lendimet trupore	31	28	35	94	95
41	Abuzimet seksuale	0	0	0	0	0
42	Rastet ne greve te urise	12	4	5	21	20
43	Tentim vetevrasjet	6	0	5	11	7
44	Vetmia - Izolimi	45	35	33	113	154
45	Vdekjet ne burg	0	0	2	2	2

Tabela numër 1, përmbledhje tre mujore e indikatorëve të aktiviteteve shëndetësore në DShB

Bazuar në tabelën numër një, ku janë prezantuar të dhënat epidemiologjike duke i krahasuar tremujorin e parë të këtij viti dhe atij paraprak, mund të konkludojmë si në vijim:


1. Ecuria e aktiviteteve dhe indikatorëve është pothuajse e njëjtë me një trend të rritjes graduale dhe jo signifikante;
2. Ka një shtim të numrit të burgosurve e si pasojë edhe e lirimeve po ashtu, pra ka qarkullim më të madh të të burgosurve gjatë vitit 2023.
3. Gjatë këtij tremujori, krahasuar me atë të vitit paraprak, ka numër të njëjtë përafërsisht të aktiviteteve si ato mjekësore, psikologjike, psikiatrike, dentare dhe total konsultime.
4. Gjatë këtij tremujori, në krahasim e atë të vitit 2022 ka shtim të lehtë të aplikimit të testeve psikologjike dhe analizave laboratorike, qofshin ato të planifikuara apo sipas indikacioneve. Këto aktivitete janë shtuar si rezultat i angazhimit të shërbimit për punë më të shtuar për parandalim të vetëvrasjeve dhe identifikimit të rasteve më çrregullime mendore si dhe për diagnostikimin e sëmundjeve të ndryshme që në pranim. Po ashtu vlen të theksohet se janë funksionalizuar laboratorët në të gjitha NjShB-të.
5. Trendi i sëmundjeve edhe këtë periudhë është i njëjtë me atë paraprake, pa ndonjë ndryshim të theksuar, signifikant.
6. Këtë tremujor, lëndimet trupore dhe indikatorët e tjerët ngjashëm janë opërafërsisht të njëjtë përpos tentim vetëvrasjet të cilat krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluara, janë shtuar në 11 por nuk ka pasur asnjë vetvrasje të realizuar .

Shërbimet e shëndetit mendor në burgje në vitit 2023 kanë vazhduar me kryerjen e të gjitha shërbimeve me theks të veçantë në masat e shtuar për detektimin dhe menaxhimin e rasteve me rrezik potencial për vetëvrasje apo vetëlëndim.

Shërbime e shëndetit mendor në burgje, duke përfshirë intervistat e para psikologjike, ekzaminimi i statusit mendor, ofrimin e këshillimit dhe mbështetjes psikologjike janë ofruar nga psikologët në format të kombinuar, edhe në zyre dhe në blloqe, pavijone e hapësira të përshtatura.

SHËRBIMET E SHËNDETIT MENDORË TË OFRUARA NË BURGJE		
Tremujori i parë i vitit	Shërbimi	Numri
2023	Konsulta shëndetësore	7570
2023	Vizita psikiatrike	1703
2023	Seanca psikologjike	2138

Tab 1. Shërbimet e shëndetit mendor në kuadër të të gjitha shërbimeve shëndetësore në burgjet e Kosovës në tremujorin e parë të vitit 2023.



Grafi 1. Shërbimet e shëndetit mendor të pasqyruara në përqindje në kuadër të të gjitha shërbimeve shëndetësore në burgjet e Kosovës në tremujorin e parë të vitit 2023.

Më shumë gjysma e shërbimeve shëndetësore, përkatësisht 50.74% e të gjitha shërbimeve mjekësorë të ofruara në burgjet e Kosovës gjatë tremujorit të parë të vitit 2023 përbëhen nga shërbimet e shëndetit mendor. Vizitat psikiatrike, vlerësimet psikologjike, seancat e psikoedukimit, këshillimit, përkrahjes emocionale dhe psikoterapisë përbëjnë shërbimet kryesore të shëndetit mendor në burgje.

Vlerësimi sistematik dhe koordinimi lidhur me rrezikun e shtuar për vetëvrasje bazuar në planin e punës dhe targetet strategjike të DShB nga stafi i shëndetit mendor në të gjitha njësitë ka vazhduar vlerësimi intensiv psikologjik për të detektuar rastet e me vështirësi në menaxhimin e gjendjes psikologjike dhe atyre me rrezik për vetëvrasje. Ky vlerësim psikologjik po kryhet në vazhdimësi përmes baterisë së testeve zyrtare të DShB për vlerësim psikologjik dhe inventarëve të tjera klinike sipas përzgjedhjes së psikologëve.

BATERIA ZYRTARE E TESTEVE PSIKOLOGJIKE	NË DSHB
<b>FUSHA E VLERËSIMIT</b>	<b>MJETI MATËS</b>
Vlerësimi fillestarë dhe i përgjithshëm i gjendjes psikologjike	Pasqyra e Përgjithshme Psikologjike
Vlerësimi i konstrukteve dhe çrregullimeve bazë psikologjike	CORNELL INDEX
Vlerësimi dhe përcaktimi shkallës së ankthit	Beck's Anxiety Inventory
Vlerësimi dhe përcaktimi shkallës së depresionit	Beck's Depression Inventory

Tab 2. Tabela e mjeteve zyrtare për vlerësim psikologjik në burgjet e Kosovës

Për rastet urgjente, të cilat në bazë të interpretimit të testeve kanë treguar rrezik të moderuar apo të lartë për vetëvrasje janë dhënë rekomandimet me shkrim për secilin psikolog, bazuar në Strategjinë për Parandalimin dhe Menaxhimin e Rasteve me Rrezik për Vetëvrasje nga Procedura Standarde e Veprimit - 2019/DShB, dhe në funksion të menaxhimit të menjëhershëm të rasteve. Rastet janë vënë në menaxhim të ekipeve multidisiplinare për menaxhimin e personave me rrezik për vetëvrasje në të gjitha burgjet. Sipas kushteve të përcaktuara në Strategjinë për Parandalimin dhe Menaxhimin e Rasteve me Rrezik për Vetëvrasje nga Procedura Standarde e Veprimit - 2019/DShB, janë arkivuar në DShB së bashku me raportet e vazhdueshme të punës së këtyre komisioneve të emëruara me vendim të përbashkët të udhëheqësve të njësisë dhe drejtorëve të burgjeve.

Aplikimi i terapisë okupuese me pacientët e krahut psikiatrik në Stacionarin e NShB Dubravë Në rrethanat e burgut me reduktim të rëndësishëm të lëvizjeve, kontakteve dhe vizitave për të burgosurit, me qëllim të mbështetjes dhe ruajtjes nga dëmi shtesë i aspektit psikologjik të burgosurve në krahun psikiatrik, stafi i NShB Dubravë po e mirëmban organizimin e terapisë okupuese brenda mundësive dhe kushteve teknike dhe logjistike. Këto forma të terapisë janë rekomanduar edhe në raportin e KPT të KE për vitin 2020. Kjo formë e terapisë është mirëmbajtur edhe gjatë tremujorit të parë të vitit 2023.

Mbështetja e komisioneve multidisiplinare për deradikalizimin e të burgosurve Edhe përgjatë tremujorit të parë të vitit 2023 stafi i shëndetit mendor në burgje ka ofruar mbështetjen e vet profesionale dhe të vazhdueshme për komisionet multidisiplinare për deradikalizimin e të burgosurve – veçanërisht në BSL dhe QK Dubravë. Gjithashtu edhe në Janar 2023 një përfaqësues i DShB ka ndjekë trajnimin për trajner me 4 module në fushën e deradikalizimit, rehabilitimit dhe ri integritit të organizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme në mbështetje të CDF. Këto njohuri gjatë vitit 2023 do të barten të psikologët e burgjeve. Plotësimi dhe avancimi stafit

Shërbimet e shëndetit mendor në burgje edhe gjatë vitit 2023 janë mbuluar nga dhjetë (10) psikolog klinik me orar të plotë të punës, (2) psikolog klinik konsultant, një (1) psikiatër i rregullt, dy (2) me gjysmë norme dhe shtatë (7) psikiatër konsultant. Po ashtu është i hapur konkursi për një psikolog klinik në NJSHB Dubravë për nevojat në Institucionin për Trajtimin e Personave me nevoja të Veçanta.

Dy nga psikologët e DShB ndjekin e stazhit specialistik në kuadër të specializimit në psikologji klinike të planifikuara e ndarë nga MSh/DShB. Po ashtu gjatë këtij tremujori është proceduar kërkesa tek bordi për specializime për ndarjen e këtij specializimi edhe për tre psikolog klinik të tjerë që punojnë në burgje në funksion të avancimit profesional të stafit, qëndrueshmërisë së stafit dhe avancimit të shërbimeve të shëndetit mendor në burgje.

Psikologët nga njësi të ndryshme janë angazhuar kohë pas kohe në trajnimet të përbashkëta me SHKK në funksion të bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve.

Të paraburgosurit me probleme të shëndetit mendor

Meqë mund konsiderohet se nga ana e DSHB është siguruar tashmë një stabilitet i stafit të shëndetit mendor, avancimi i tyre profesional si dhe kushtet teknike e logjistike për punë. Sfidë e rëndësishme edhe në vitin 2023 mbetet numri i madh i të paraburgosurve me probleme të natyrës psikike për të cilët gjykata ka lëshuar një urdhër për vlerësim apo trajtim të detyrueshëm në IPFK por në mungesë të vendeve në IPFK mbahen nëpër qendrat e paraburgimit duke e mbingarkuar kështu stafin e shëndetësor në përgjithësi dhe stafin e shëndetit mendor në veçanti.

Mungesa e supervizionit për ofruesit e shërbimeve të shëndetit mendor

Supervizioni apo mbikëqyrja profesionale në fushat e shëndetit mendor përfaqëson procesin përmes së cilit profesionisti vazhdimisht merr shërbime personale, nga një supërvajzer me përvojë, me qëllim të ruajtjes së mirëqenës së vet psikologjike e cila është e cenuar vazhdueshëm nga procesi i punës me pacient me problem mendore. Mungesa e një shërbimi të tillë në nivel kombëtar ka pamundësuar një implementim të tij edhe te stafi i shëndetit mendor në burgje duke reflektuar drejtpërsëdrejti edhe në kualitetin e punës dhe mirëqenien e stafit.

Sa i takon indikatorëve të tjerë specifik rezulton se në këtë tremujor, ashtu edhe në atë të vitit 2022, shumica e indikatorëve kanë një përqindje të ngjashme. Dallim bënë shtimi i përqindjes së duhanpirjes dhe përdoruesve të drogave të cilët ende janë në një përqindje të lartë.

Raportimi i tremujorit të parë, për vitin 2023, per disa indikatorëve ne burgje							Të dhënat për tremujorin e parë të vitit 2022	
Nr	Lloji i të dhënave	Janar	Shkurt	Mars	Total	Përqindje	Total	Përqindje
1	Numri i te vizituarve për herë të parë	554	389	475	1,418	100.00	1,322	100.00
2	Numri i duhangjinjeve	403	256	322	981	69.18	902	68.23
3	Numri i abuzuesve të alkooholit	22	29	45	96	6.77	105	7.94
4	Numri i abuzuesve të drogave	83	74	80	237	16.71	222	16.79
5	Rastet me Hepatitis B	0	0	2	2	0.14	2	0.15
6	Rastet me Hepatitis C	0	0	1	1	0.07	4	0.30
7	Rastet me lendime trupore	26	21	31	78	5.50	82	6.20
8	Rastet me TBC	0	0	0	-	-	1	0.08
9	Rastet me Diabet	23	4	12	39	2.75	26	1.97
10	Rastet me SST (AIDS)	0	1	1	2	0.14	-	-
11	Rastet me Hipertension Arterial	50	24	33	107	7.55	83	6.28

Tabela numër 3, përmbledhje tre mujore e disa indikatorëve specifik te DShB

Rastet e varura nga drogat, janë trajtuar në vazhdimësi në mënyrë adekuate dhe përmes programit të metadonit në të gjitha NjShB-të.

Raportimi i tremujorit të parë, për vitin 2023, për disa indikatorëve në burgje							Të dhënat për tremujorin e parë të vitit 2022	
Nr	Lloji i të dhënave	Janar	Shkurt	Mars	Total	Përqindje	Total	Përqindje
1	Numri i te vizituarve për herë të parë	554	389	475	1,418	100.00	1,322	100.00
4	Numri i abuzuesve të drogave	83	74	80	237	16.71	222	16.79

Tabela numër 4, përmbledhje tre mujore e disa indikatorëve specifik të DShB

Në këtë periudhë nuk ka pasur raste të infektuar me Coronavirs. Ka vazhduar zbatimi i masave kundër epidemiologjike, si DDD e të gjitha hapësirave të burgjeve, higjiena personale dhe e hapësirave.

Furnizimet me material mjekësor, administrativë, të higjienës dhe mjete mbrojtëse ka qenë i qëndrueshëm dhe sipas planit.

Vështirësi ka pasur dhe ende ka në furnizimi me barëra si pasojë e mos nënshkrimit të kontratës dhe ankesave në proceduar gjyqësore.

Disa herë kemi bërë përpjekje për proceduar urgjente por edhe ato kanë dështuar. Furnizimi ka munguar dhe rezervat janë shterur. Në këto ditë është duke u zhvilluar një procedurë tjetër urgjente e cila shpresojmë që të zgjidhë këtë çështje mjaftë me rëndësi e cila ka rrezikuar edhe shëndetin e edhe sigurinë në burgje.

Në këtë periudhë është inauguruar Institucioni për kujdesin e personave me Nevoja të veçanta në burgun e Dubravës me kapacitet prej 81 vendeve të parapara për persona me nevoja të veçanta në lëvizje dhe moshë, ata me sëmundje kronike të vazhdueshme e që kërkojnë trajtim mjekësor permanent, personat me çrregullime psikiatrike të dënuar dhe personat përdorues të drogave. Ky projekt është mbështetur nga Ambasada Amerikane dhe INL, ndërsa buxheti dhe financimi për staf, pajisje dhe barëra me material mjekësor janë të buxhetuara në planin e buxhetit.

Ka filluar së zbatuari Projekti me Këshillin e Evropës, i cili do të zgjasë për 36 muaj dhe do të kushtoj 850,000.00€. Deri me tani janë kryer këto aktivitete: Është bërë Lansimi i Projektit, konstituimi i Komitetit Drejtues – KD, dy asesment-ve, njëra në dhjetor dhe tjetra në janar, në proces zbatimi i Rekomandimeve nga të dyja asesmentet, janë mbajtur tri punëtorit të organizuar deri me tani nga Projekti me të dyja komponentët për Shëndetin Mendor dhe DShB ku janë rishikuar PSV-të dhe janë marrë inputet nga grupet punuese dhe janë prodhuar rezultatet.

Buxheti është planifikuar sipas nevojave dhe është bërë plani i rrjedhës së parasë i cili është duke u zbatuar.

Kemi bërë kërkesa për Inspektime nga inspektoratet relevante në fillim vit, përfshirë edhe Auditimin e brendshëm.

Kemi respektuar planin e Prokurimit dhe kemi dërguar për procedurë të gjitha kërkesat, të cilat janë në përfundim e sipër.,

Gjatë këtij tremujori është kryer monitorimi dhe përcjellja e punës përmes komunikimit dhe raportimit të rregullt javor dhe mujor nga të gjitha njësitë shëndetësore të burgjeve.

Janë lëshuar 13 raporte mjekësore e psikiatrike, sipas kërkesës se te burgosurve, familjarëve dhe avokatëve te tyre.

Është kryer rekrutimi i 15 punëtorëve të ri shëndetësor, 11 infermierë dhe 2 mjekë kanë filluar punën me 1 mars te këtij viti ne NjShB Dubravë, ndërsa 2 nga këta infermierë kanë filluar punën ne NjShB

Në vazhdimësi jemi dukë zhvilluar aktivitete lidhur me menaxhimin e gjendjes shëndetësore te të burgosurve dhe ndërmarrjen aktivitete përkatëse, bazuar në planin e punës dhe PSV-të për trajtimin shëndetësor te të burgosurve.

Ju faleminderit për mirëkuptimin.

Me respekt!

